



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1443 Prot.

Tiranë, më 16.07 2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 110 datë 16.07 2026

“PËR

NJË NDRYSHIM NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS “

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, nenit 38, pika 1, gërma (ç), në Statutin e UST-së neni 20, gërma dh), në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, në Vendimin e Senatit nr.13, datë 30.01.2026 “Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.11, datë 02.02.2026 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026”, në shkresën e Ministrisë së Arsimit me nr. 1198/1 prot., datë 13.07.2026 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, Senati

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës,
 - **Znj. Blerina Behar Aliaj**, me gradë shkencore “Doktor”, kategoria “Lektor” pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, kategoria “Profesor i Asociuar” nga data 11.06.2026 e në vazhdim.
2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

